



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

NDËRMARRJA KOMUNALE PLAZH

Nr. _____ prot

Durrës, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje kazan metalik”.

Vlera e fondit limit: ; 4.995.000 (katërmilion e nentëqind e nentëdhjetë e pese)leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të [ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Komunale Plazh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin Neni 82, i LPP Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë

paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të [ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të [ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#) dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”e ndryshuar, nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që deshmimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkrues, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#) dhe nenit 40, pika 6, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kërkesave si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Certifikatat Si më poshte:
 - Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate ISO 9001:2015 të prodhuesit, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njevlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, të perkthyer dhe noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Ne Çertifikate ISO 9001:2015 duhet të jetë e përfshirë Objekti i prokurimit.**
 - Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate konformiteti EN 840-3:2020, EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020 të prodhuesit ose ekuivalente.

Për standardet e mësipërme, AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO etj, mbi konformitetin e standardit evropian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, te [ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

- a) Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001: 2015 (e velfshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

- b) Kriteri që OE duhet të duhet të paraqesin Çertifikate konformiteti EN 840-3/5/6 të prodhuesit, për shkak se standardet **EN 840-3:2020**, **EN 840-5:2020** dhe **EN 840-6:2020** lidhen drejtpërdrejt me parametrat teknikë, sigurinë dhe testimin e konteinerëve të mbetjeve, vendosja e tyre në specifikimet teknike është e nevojshme për të garantuar që mallrat e furnizuara të jenë funksionale, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim me automjetet ekzistuese të shërbimit të pastrimit.

Standardi **EN 840-3:2020** përcakton kërkesat për dimensionet, konstruksionin dhe kompatibilitetin teknik të konteinerëve me sistemet standarde të ngritjes dhe zbrazjes, duke garantuar përdorim të sigurt dhe funksional në procesin e menaxhimit të mbetjeve. Ndërsa standardet **EN 840-5:2020** dhe **EN 840-6:2020** përcaktojnë kriteret e performancës, sigurisë dhe metodat e testimit për rezistencën mekanike, qëndrueshmërinë, kapacitetin mbajtës dhe jetëgjatësinë e konteinerëve gjatë përdorimit të vazhdueshëm.

Përcaktimi i këtyre standardeve synon gjithashtu garantimin e sigurisë në punë për personelin e shërbimit të pastrimit dhe sigurimin e një niveli cilësor të pranueshëm sipas standardeve europiane për administrimin e mbetjeve urbane.

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE Deklarate në të cilën të marrë përsipër përbushjen e specifikimeve teknike duke cilësuar për çdo produkt sipas kërkesave të AK si dhe realizimin e kontratës sipas afatit 15 ditor.

Argumentim: Në bazë të nenit 36 të [ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kërkesave dhe specifikimeve.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi.

Sa me sipër mjete nevojitet të jete i pajisur me :

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të cilin fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- a) Kontratë qiraje.
- b) Leje qarkullimi e mjetit.
- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- ç) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të [ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#), dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për transportin e materialeve të pastrimit në adresat e të gjitha autoriteteve kontraktore . Në zbatim të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, ku përcaktohet “6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

6. Operatori Ekonomik Pjesemarrës në datën e zhvillimit të tenderit do të paraqesë mostrat e produkteve të shoqëruara me skeden teknike. Tabela si më poshtë:

Nr	Emertimi i Mallit	Njesia	Sasia
1	Kazane metalik me kapak plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra.	Cope	1

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Ndermarrjes Komunale Plazh, Durres, me adresë: Lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara .

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

Mosparaqitja e mostrave sipas kushteve të caktuara më sipër është kusht për skualifikim

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.
- Malli do të dorëzohet në prani të komisionit të marrjes në dorëzim në Magazinën e NKP Durres, lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja.
- Furnizimi do të bëhet brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Ofertuesi fitues do të shoqëroj mallin me këto dokumentacione:

- Faturen Tatimore e Mallit
- Skeden teknike të produktit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Mos plotësimi i kritereve të mesipërme nga ana e Subjektit Ofertues është kusht për skualifikim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, të [ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”](#), ndryshuar me ligjin në [Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin](#)

Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike.

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

8.Specifikime per “Kazanët metalik”

Specifikime teknike

1. Kazane metalik me kapak plastik per mbetje urbane me kapacitet1100 Litra.



Foto ilustruese

- Kapaciteti i mbajtjes i kontenierit te jete 1100 litra.
- Permasat e kontenierit:
 - Lartësia: 1470 mm ±5%
 - Gjerësia: 1370 mm ±5%
 - Thellësia: 1080 mm ±5%
 - Spesori i lllamarines te jete 1.5
 - Trupi i kontenierit te ndertohet nga lllamarine çeliku me stampim ne te ftohte.
 - Trupi i kontenierit te jete i galvanizuar dhe i llyer me bojë pluhur elektrostatische të pjekur në temperaturë të lartë, me rezistencë të lartë ndaj korrozionit, lagështirës. Ngjyra do të percaktohet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor mbas lidhjes se kontrates.
 - Kontinieri duhet te jete i loguar me logon si me poshte:



Ngjyra e logos do të percaktohet sipas kërkeses së Autoritetit Kontraktor mbas lidhjes së kontrates.

- Kontenieri të ketë ekstra përforsim të bazës së rrotës, e cila të jetë e ngjitur tek kontenieri.
- Kontenieri të ketë sistem kullimi në pjesën e poshtme për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit.
- Kontenieri të ketë në trup dy doreza anësore për të bërë të mundur terheqjen e tij.
- Në kornizën e sipërme të perdoret profil përforsues
- Kontenieri të jetë i pajisur me kapak plastik HDPE kundër rrezeve UV dhe djegies nga zjarri.
- Kapaku të jetë i pajisur me doreze, për hapjen së kapakut në mënyrë manuale.
- Kontenieri të ketë 4 rrota gome të kthyeshme, të ndertuara me material gomë plastike, bashkë me kuzhineta, dy nga rrotat të jenë me frenues
- Diametri i rrotës të jetë 200mm dhe me rrotullim 360°.
- Rrotat të jenë të nderuara me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën.
- Kontenieri të jetë në gjendje të durojë kushtet klimaterike të ndryshme, për të gjithë përbërësit, dhe temperatura nga -20°C deri +50°C.
- Kontenieri të jetë sipas standarteve EN 840 3/5/6-2020 ose ekuivalent.
- Kontenieri të jetë konform standartit CE dhe në dokumentacionin teknik shoqëruar të përmbajë markimin CE (stampuar në trupin e kontenierit)
- Prodhuar nga prodhues të certifikuar sipas standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent.

Shënim: Ngjyra do të percaktohet në momentin e lidhjes së kontrates, sipas kërkesave të AK

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punes ngritur me urdher nr 264, date 14.05.2026, miratuar nga titullari i AK, bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhenenit 36, të LPP, si dhe nenit 42 dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Specifikimet teknike të hartuara për këtë procedurë prokurimi janë përcaktuar në funksion të natyrës dhe objektit të kontratës, me qëllim sigurimin e furnizimit me kontenierë të cilët garantojnë funksionalitet, qëndrueshmëri, siguri në përdorim dhe jetëgjatësi në administrimin e mbetjeve urbane.

Kërkesat teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë kushtet e përdorimit të përditshëm, nevojat operative të Autoritetit Kontraktor, kompatibilitetin me sistemet ekzistuese të transportit dhe grumbullimit të mbetjeve, si dhe nevojën për minimizimin e kostove të mirëmbajtjes gjatë përdorimit.

Specifikimet e përcaktuara synojnë garantimin e një produkti cilësor, rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit intensiv, duke siguruar njëkohësisht standardet e nevojshme të higjienës, sigurisë dhe eficiencës në shërbimin publik.

- **Afati i levrimit: Furnizimi do të bëhet brenda 15 diteve nga nënshkrimi i kontrates, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.**

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.